

DJH-1
P 55

KOÇI
PETRITI

Të dashurova
W

vjersha
dhe
poema



D A S H U R I A

Ish një vajzë
e ish një djalë,
vajza e donte
e djali e donte,
po Shkumbini i madh me valë
i kish ndarë e s'i bashkonte.

Dhe thërrisnin:

Ooo, të dua,
po kjo klithmë e lashtë fjalësh
u dëgjohej:

Jooo, s'të dua,
nëpër thashetheme valësh.

E humbisnin të dy shpresën
e shpresonin prapë më tepër,
siç humbet dhe dita vesën
dhe e gjen mëngjesin tjetër.

*Ooo, tē dua, nisej fjala,
joo, s'tē dua mbërrinte zallit,
vajza thosh:*

*Më piftē vala,
tē pērpiftē,
i vinte djalit.*

*Hidhnin fjalën ta kalonin,
shprishej porsi plisi i kumit,
hidhnin gurin tē qëllonin,
binte mu në mes tē lumit.*

*Bot, me buzë, bot me duar,
afér dallgës së ndërkryer,
herë pér jetë dashuruar,
herë pér vdekje tē zhgënjyer.*

Një çast lumi

*s'ish më lumë
mes dy maleve të mallit,
dhe u bind e ra në gjumë
dhe u hap e fjeti zallit.*

Rendi vajza e

*rendi djali
sa u ngrit një erë e marrë
që rrëzoi shkëmbinj nga mali
e një breshër që s'ish parë.*

Zgjatën duar,

*vunë gurë,
shtruan dhembjet që nuk thuhen
gjer mbi lumë u bënë urë
të kalojnë ata që duhen...*

Ish një vajzë e ish një djalë...

VALLJA GORARE

Me një shtyrje gjuri ngjitet,
me një thyerje gjuri zbret,
sikur ecën nëpër vitet
e çon historinë e vet.

Me çdo palë fustanelle
fllade mbledh, furtunë përcjell,
herë muros një mur kështjelle,
herë përkulet, lule mbjell.

Sa shpalos një shenjë shamie
nga mëngoret e mëdha,
del një re thëllëzërie,
sikur plot me zogj i ka...

Pa kur bën një shënjë me vetull
ç'gurrë gërnetash rrokullis,
njëqind shqipe mbledh nën sqetull,
dyqind shqipe larg i nis.

A B H A U X

Dhe me një shtrëngim të dorës
shoku shokun supit kap,
brof të shohë nga mali i Gorës
mbi Tomor e mbi Korab.

Nën opingat xhufkëkuqe
tokën dredh e ajrin gris,
herë përzen një nisje lufte,
herë në hon një xhind gremis.

Dhe me vetëtimë të xhufkës
burri burrin rrok në krah,
brof të shohë nga sheshi i luftës
përtej maleve çfarë ka!

Me një shtyrje gjuri ngjitet,
me një thyerje gjuri zbret,
sikur ecën nëpër vitet
e çon historin e vet.

K U D H R A

Tregojnë se «zhdukej» prej zyrës ai,
«braktiste» karrigen që mban
dhe thanë: ta shohim ku shkon ky njeri,
dhe e gjetën diku me çekan.

Shaluar mbi kudhër ngre dorën dhe rreh
një hekur të rëndë e köndon,
kam qenë këtu e jam ngjitur atje,
kjo kokë këtë s'e harron.

Kam qenë këtu pa jam ngjitur atje,
mendon e mes njerëzve zbret
e populli djalin e do dhe e ngre
në shkallët e ngjitjes së vet.

Dhe frynë e shfrynjë stuhi të mëdha,
nga shkallët ra një, edhe një,
po kurrë ai s'u lëkund e nuk ra
se kudhrën taban kish nën të.

*E kurrë ai s'u bë tym e tufan,
nuk shkeli si xhind sipër kudhrës,
mbi katër «potkonjtë» e karriges që mban
a mbi katër «patkonjtë» e veturës...*

N O T A

Thonë s'ngre peshë firma jote,
gabohen sigurisht
se ti nën një gërvishjtje note
fsheh dhelprën me gjithë bisht.

Dhe mund ta vësh atë dhe shtatë,
po mund ta vësh dhe dhjetë,
sikur ta paska lënë yt atë
ta ngresh ujin përpjetë.

E ndonëse, s'je as kuzhinier,
as shitës me banak,
të bie nota erë derr,
të bie erë konjak.

Të bie nota erë, të bie
se kjo djall jetë private
qenka plot prova grykësie,
plot ngasje delikate.

Dhe ky kompleks kaq delikat
t'ushqen diçka kthetrore,
të rrit ca thonj që nis i zgjat
në thelën shoqërore.

Dhe mund ta vësh atë dhe pesë,
po mund ta vësh dhe katër
për iks kunatë, a krushkë, a mbesë
që ty s't'u mbajt me hatër.

Kaq ke në dorë kaq bëke ti,
kaq bëke sigurisht,
sikur të kesh thonj si ari
a s'do të bëje iks,

A s'do të bëje ypsilon,
a zetë sikur, sikur
të jesh një shef në një seksion
i ngjitur gur mbi gur?

*Dhe shumëzojini tani
iks, ypsilon e zet'
sikur të jesh në ministri,
sikur të kesh pushtet.*

*Sikur... Po nga ky rregull treshi
e gdhin, po shpesh s'e ngryske
sepse të kapkan dhe për veshi,
me hundë ç'u përbyske.*

L I S I

*Pat parë kungulli hardhinë
përdredhur pas një lisi,
dhe hop mbi gardh e bot mbi shpinë
t'i ngjitet lisit nisi.*

*Dhe kur në majë u ngjit me vrull
e ndjeu veten mbi fron,
sa vjet je ti, i tha fodull,
që përmbi botë rron?*

*Ke qindra vjet me gjithë hardhinë
dhe paske këtë shtat?
Shih unë, vetëm me një stinë
sa ty u ngjita lart!*

*Dhe qeshi lisi e mori frymë
e rrënjet thellë i shtriu,
e zu një ngricë e ra një brymë
e fryu e shfryu veriu.*

E fryu e shfryu, po dot s'e tundi
nga dheu tē lashtin lis,
veç kungulli tē mbahej s'mundi,
po poshtē u rrokullis.

S H Q I P O N J A T

Kishte ardhur nga dhera të tjera
më i egri armik ndër armiq
siç vjen dimri e hyn tek pranvera
siç vjen gjarpri e shkel mbi iriq.

Kur mes tyre u shfaq majë kalit
pa se syri asnjerit s'iu tremb,
ata shihnin në shpatull të malit
një shqiponjë që sillej mbi shkëmb.

Ata shihnin drejt shpendit të lirë
ai egër vështron te ata,
t'i shkretonte ndjeu duf e dëshirë
që asnjeri më gjunjë s'i ra.

Edhe kali ha frerët me dhëmbë,
kur të zotin e sheh pa pushtet.
Ai priste t'i binin ndër këmbë,
ata shpinën e ngrinin më drejt.

*T'i gjymtonte me radhë e me radhë,
ujkërisht mbi çdonjërin u ndal.
Si t'ua shkundte qeleshen e bardhë,
të pashkelur si bora mbi mal?*

*O sa shumë mënyra përdori,
më dinaket që njihen mbi dhe,
po dot shqipen nga gjoksi s'ua nxori,
vriste një, prapë ata pillnin tre.*

*Dhe më shumë egërsi se për shqipen
kish për njerzit me emrin e saj
dhe po plakej e s'gjente dot shpikjen
si t'i shuante ata skaj më skaj.*

*Sheh përqark e ul sytë e ngre sytë
e mendon e mendon e mendon,
mbi oxhak të një kulle të ndytë
një folezë lejlekësh vështron.*

*Asnjë fjalë nga buzët nuk nxori,
po shkreptima e syve të tij
shkroi një shkrim të gjakosur gjaksori
e nënshkroi një vendim ogurzi.*

*Dhe sejmeni që prapa i rrinte
e ç'mendonte kuptoi dhe s'kuptoi,*

*u bë gati mbi shpendin të shtinte,
po në çast dora e tij e ndaloi.*

*Ngjitu fshehur, i tha, gjer te kulmi,
në ka vezë t'i zbresësh këtu,
t'i s'e merr dot me mend se çfarë sulmi
do të shohin pastaj sytë e tu.*

*Zot i egër enigmën e gjeti,
po dhe gjatë të priste s'kish nge,
zieja vezët, i tha, dhe së fshehti
të m'i ngjitësh sërish në fole.*

*Dhe ia zienë e ia vunë te foleja
edhe çiften s'e shkrehën aspak,
e gjakosur mbi ta u bë reja,
kur lejleku u ul mbi oxhak.*

*Pastaj shkoi si pat ardhur pranvera,
shkoi dhe vera dhe vjeshta me shi,
rrri lejleku mbi vezët e ziera,
rrri mbi t'ardhmen e vrarë e s'e di.*

*Rri lejleku mbi zogjtë e padalë
shiu e lagu dhe vapa e dogj
ai n'ëndërr sheh veten mbi kalë
se si shkel mbi qeleshe dhë zogj*

Rri lejleku pa ditur ç'ka ngjarë
e s'i ndien më as ngricë as tufan,
gjersa ra një mëngjes bora e parë
e foleja iu vesh me savan.

E kur shpendi që lart kokën vari,
ai mblodhi sejmenët rrëth tij
e me duf e triumf sundimtari
shpalli shkoqur mendimin e zi:

Ja, kështu, tha, e dua sundimin,
vrisni, prisni, pa krisma, pa gjak,
si lejleku që preu fluturimin
e kujtoi se ish zot mbi oxhak.

Dhe u sulën sejmenët nën hënë,
lidhën burrat, po burri iu tha:
Mos harroni që ne edhe mbrëmë
kemi fjetur në vatra me gra.

Dhe u sulën sejmenët me natë,
që t'i gjenin ku t'ishin ato
dhe i thirri atij një nga gratë:
Djemtë do, ja, atje i kërko!

Ato shihnin drejt shpendit të lirë,
ai egër vështron te ata,

*t'i shkretonte ndjeu duf e dëshirë
që asnjeri më gjunjë s'i ra.*

*O sa shumë mënyra përdori,
më dinaket që njihen mbi dhe,
po dot shqipen nga gjoksi s'ua nxori,
vriste një, prapë ata pillnin tre.*

*Se shqiponja që pjell majë shkëmbi
s'ish lejlek që gënjetet kollaj,
aq më tepër njeriu i një vendi
që mban emrin e bukur të saj.*

P O E Z I A

Tani kam njohur shumë njerëz
dhe kë kam shok e mik e di
e s'hesht siç hesht njeriu-lavjerës,
kur hesht mik, zembëreku i tij!

E di ç'kërkon prej meje koha,
e di dhe ajo ç'marr unë prej saj,
nëse me tjetër varg s'e ngroha
jemi të dy fajtorë pa faj!

Mbi gurët ku më shkeli këmba
me ecejak njëzet vjet rresht
kam shkelur edhe përmbi gjemba
e prapë s'më bënë dot të hesht.

Dhe nëse floku im ka zbardhje,
e udha ngrënje shollësh ka
nën të përditshmet vajtje-ardhje
zbulova zjarre të mëdha!

*M'u grisën shollët, i arnova
e ç'gur desh më pengoi e di
e prapë mbi të unë shkela e shkrova
veç njerëzoren poezi!*

L O K O M O T I V A

Në ndodhtë

të dremit,

e s'ndiej

si pulsi

i kohës rreh,

ti shkundmë

e zgjomë

e larg më ço,

e vec troko,

gulço,

gjëmo!

Ti krismë

e klithmë

e thirrje

e marsh,

me gjoks

e ballë

e bërryl

blindazh,

që shqep
e shqyen
çdo tufan,

hamall
që jetën
mbart
revan...

Në trokun tënd me vrap veriu
merr frysë
e rrön
e vlon
njeriu,

njeriu që bën
dhe shkëmbin
shpend

e sulm për sulm
vetveten gdhend.

Në trokun tënd
merr frymë e vlon
njeriu
që kreu
revolucion,
që dhe në gjoks
e sqetull mban
lokomotivën
duf-tufan.
E gjithë ky duf
që brenda zien,
e bëhet trok,
trumbetë
e tren,

më shkund,
më tund,
më zgjón,
më ngjeth,
mendim
e varg
në sulm
m'i hedh...

ALI KELMENDI

*Tërë jetën rendi
e rendi
e rendi*

*të parathosh Botën e Re,
me vajtjeardhjen e një shpendi
që as çerdhja e vet,
as qelli i vet s'e nxe.*

*Dhe s'ish dallëndyshja e vjeshtës së Hygoit
që çfarë s'ka parë, veç dimrin jo.
Shkoi larg e pas la diellin e heroit
që mbasi perëndon më tepër ngroh.*

*Në çdo kënd dheu sikur të vdiste
kjo tokë prapë do t'i thosh «bir»,
çdo komb «vëlla» do t'i thërriste,
çdo popull do ta kish martir.*

E P I T A F

Ai

jastëkthin
e karriges
e ngrohu një jetë të tërë,
aqsa si pjesë e prapanicës,
i ngjan sikur i qenka bërë.

Dhe i rrite brazdave të trurit
sinori i ri i pronës,
siç rritet, po s'u mpreh pas gurit,
dhe sqepi i kthyer i shqiponjës.

DHIMBJA E POETIT

Nga dhimbja ime dalin zogj,
skifterë hapësirash
e ç'kam në zemër e shkërmoq
në copra xhevahiresh.

Se copra xhevahiresh ndaj
me vargun tim blatonjës
e pasuri për vete mbaj
veç pendën e shqiponjës.

NJË TUFËZ BAR

*Një tufëz bar me brishtësinë e barit,
një tufëz bar i butë si gëzof,
ka mbirë ku shkel këmbë e kalimtarit
dhe unë rri mendoj si filozof:*

*Pa shih, kjo brishtësi e butë,
asfaltin çau për dritë e kaltërsi,
eh, ç'mund të bëjë me këmbëngulje e luftë
njerëzimi i tërë i ngritur për liri!*

Z E M È R I M

Një zemërim kaq të trazuar
rrallë e kam ndier gjer më sot,
ti qesh që qenkam kreshpëruar
sikur të isha donkishot.

Po t'isha donkishot i krisur
do të të kapja, s'di se si,
këmishkat kisha për t'ua grisur
zonjusheve që ruan ti.

E do t'i klithja edhe trenit:
Pa ndal, këtë rrufjan ta flak,
pastaj në sy të ty modernit,
le t'isha bërë qesharak!

Ti me zonjushet në sedilje
je shtrirë e qofte po llufit,
e njëra bie erë vanilje,
e tjetra çamçakiz mbllaçit.

M I S A M A S

Ē kjo fshatarja mban mbi supe
një foshnjë që rënkon e s'fle,
ndërsa «modernia» jote s'mundet
t'i shtyjë tulet pak më tej.

Jot bijë e vogla në hartime
ka shkruar bukur, domosdo,
që bën dhe sakrificë sublime
për njerëzit që aq shumë i do (!)

Dhe ja, si jetën e dhuroka,
kur ky njomzak rënkon përkrah,
përtyp mastikë e u ankoka:
Ua, ç'm'u zu fryma, moj mama!

S'e di ç'pozitë i ke vënë kokës,
në je hiçgjë a profesor,
veçse nuk je nga të nëntokës.
as dhe njeri që mbjell e korr,

Që s'vjen nga turnet e uzinës,
që konsumon ti mish përditë,
të njoh nga ky kostum i stinës,
të shoh nga cipa që të ndrit.

Po kushdo qofsh, s'të ndahem unë,
në bën kështu siç bëke sot,
do të të ndez mbi zverk furtunë,
pa le të jem dhe donkishot!

M A L L

*Udhëve të Korçës veç dëborë bie,
jo s'qenka dëbora, po mall fëmijërie,
sikur të mos ishte kjo dëborë malli
do t'isha i vdekur, ndofta që së gjalli...*

G R A T E

*Në ndodh të grindemi me gratë,
kjo ka një shkak universal
që jeta s'është as muaj mjalti
dhe as piknik e festival.*

*Por po të flisnim veç për grindje,
pa çmuar dashurinë për to,
do të ish një lloj sikur në lindje
të dilte hëna
e dielli jo...*

B I S H T I

Dhe s'kishin mall për punë
dhe ngroheshin më nge
e tjetrit bisht i vunë,
një bisht që askush s'e sheh.

Ia zgjatnin, ia shkurtonin,
pas shpine sigurisht,
e njëri-tjetrin shponin:
Shiko, se ç'bisht, për Krisht!

Ata që mendjen s'vranë
të dinin qysh e pse,
ky meritoka, thanë,
t'i varin teneqe!

Nxitonte tok me ditën
njeriu që s'kishte nge
dhe bishtin që i ngjitën
me ç'sy ta vinte re?

*Se një e kish «pa dashur»
e tjetri «pa qëllim»
e autori i bishtit
na mbetej anonim.*

*Prit, bir, tha një i zgjuar,
një rrodhe të të heq,
që dor' e djallëzuar
ta ngjiti për të keq.*

*Njeriu «me bisht» pa prapa,
ndjeu dhimbje, po s'u ndal,
vazhdoni, tha, ju zhaba
avazin në kanal.*

TË DASHUROVA TY

Të dashurova Ty

dhe desha shumë gjëra,
aq shumë sa shpina m'u kërrus nga pesha
e tyre,
shpina m'u kërrus,
zemra m'u zgjerua,
aty janë ulur shesh të gjitha ato që dua,
të gjitha ato që mbroj me rreptësi
prej nga më buroi dhe e gjithë kjo dashuri.

Të dashurova Ty

dhe harrova moshën time,
e thura këngë të reja
e grisa shumë kujtime,
e desha të tjera ritme
e mora të tjera fluturime.

Dhe e vesha merakun e nënave me kapotën
e ushtarëve,
u ndala më gjatë para lapidarëve.

Të dashurova Ty
dhe i luftoj më ashpër meskinët,
e hahem më guximshëm me burokratët.

E pashë më realisht jetën
dhe më joshën muskujt e bronztë
dhe i vështrova me nderim kërkuesit dhe
studiozët.

Të dashurova Ty
dhe u bëra më i kujdeshëm,
u bëra më tepër i ndjeshëm,
u bëra më pak i pasjellshëm.

Dhe s'vura asgjë mbi duart e ndershme
të punëtorëve
e i hetova me sy prindëror retinat e
televizorëve,
e hetova më me vëmendje detin,
e pashë si aleat malin,
u bëra m'i ndershëm ndaj djersës,
u lidha më fort me metalin.

S'u deha nga parfumi kalimtar
i bulevardeve,
mendova për shkumën e djersës në
këmishën e korriësit,
shkumën e djersës së kalit nën ndënjosën
e kalorësit.

*Parfumin kalimtar tē bulevardeve unë
e dua,
e dua fērfērimēn e fustanit erēmirē,
po kurrē s'do tē harroj ç'ngarkesë ka një
grua
që shkon tē prashisë e tē korrē që pa
gdhirë...*

*Tē dashurova Ty
dhe kēmbēngula edhe mē shumë
tē shëmb e tē ndërtoj gjithnjë sulmues dhe
i pagjumë,
luftoj rreptë gjithë ata që rreth tryeze
duan t'i kthejnë serrat pjellore
në kuzhinat e tyre mikroborgjeze.*

*S'u shqetësova për tē paaftin që u ngrit
në përgjegjësi,
sa për shpatullat që do tē mbartin gurët
e paaftësisë së tij.*

*Tē dashurova Ty
dhe urreva gjithë ato telefonata
që pengojnë urgjencat shitetërore
me kotësira mamakash e listëporosi tē gjata.*

*E ndiej neveri për atë që mendon e ëndërron
e lufton
ta ketë mirë me tē gjithë e «si urdhëron»
me tē gjithë,*

me buzëqeshjet e pështira,
që ta brejnë zemrën si urithë.

Dashurova të dashuruuarit
dhe urreva gjithë gratë
që burrin e ndershëm shtrëngojnë për
krahu
dhe shesin vështrime kontrabandë.

Urreva gjithë dhëndurët mes dhomave
çmendurisht të mobiluara,
që me kravata moderne lidhin mblesëri
të demoduara.

Dhomat e mobiluara, ku reklamohen
serviset,
kompletet,
pasqyrat,

e shkollarëve s'u mbetet vend ku të
shkruajnë detyrat,
e shtrohet tapeti e qëlimi me katër fletë
e të përgjumin perdet e s'marrin frymë
bufetë,
veç libri mungoka në këtë fund shekulli
të njëzetë...

Të dashurova Ty
e të më falin kushérinj e krushka
e dajllarë,
që kohë s'më mbetet të shtrohem
këmbëkryq ndër vizita e jubilarë,

*dashurinë e kam shtrirë në më tepër njerëz
sesa fisi,
le të më quajnë pinjoll mendjemadh,
le të më shajnë pas kurrizi.*

*Të dashurova Ty
e s'bie në grackën e thurur me fjalët që
joshin,
fjalët që joshin pastaj hyr e dil të
mbështillen rrëth zyre
duan ta hedh e ta pres telefonin si zuska
kodoshin.*

*E s'bie në grackën e zarfit mitdhënës,
që hyka nën derë a vjen si peshqesh për
ditëlindje,
vjen për ditëlindje a fejesë, a thjesht dhe
për kollën e nënës,
kollën a mishin e huaj në hundën e vjehrrës
që fle me gérhitje.*

*Të dashurova Ty
dhe luftoj burrërisht për popullin tim,
luftoj gjithë laperët, dallkaukë, frazeologë,
gjithë ata që kanë rrahur me vetëmburrje
gjoksin
më tepër nga ç'korr bujku kallinj gruri nga
kjo tokë.*

*Sulmova e rrëmbeva lahutat e luftëtarëve
të lirisë,*

*shkunda gjithë telat,
gjakosa gjithë gishtat gjer në eshtër
dhe me palcën e gjëmave dhe të këngëve
epike
u lidha në rrënjet e motivit të kohës sonë
heroike...*

*Të dashurova Ty,
të endërrova Ty,
Komunizëm...*

MONUMENTI

*Kur thuhej se shqiptarët donin
ta ngrinin Gjergjin mes Tiranës,
i shqetësuar Jakomoni
i shkruante urgjentisht Çianos.*

Dhe kont Çiano
Musolinit
e Musolini

Jakomonit:
*Më mirë duart lart t'i ngrinit,
nëse këtë s'do ta sfidonit!*

*Daljen në skenë të Skënderbeut
ta sprapsni me çdo lloj mënyre,
më mirë e ngremë pranë Koloseut
sesa të flasë midis tyre:*

*N'intimitet të prapaskenës
me njëri-tjetrin sikur thanë:
S'e patën keq ata të Vjenës
që atë shpatën nuk ua dhanë.*

Daljen në skenë të Skënderbeut
ta sprapsni me çdo lloj mënyre,
më mirë e ngremë pranë Koloseut
sesa të flasë midis tyre.

T H E N G J I L L I

*Mbështjellë me fljimin e vetvetes,
përbrenda ngrohtësinë e prushit mban,
në qetësinë e fjetur vdes në heshtje,
kur era fryn, shkëndija nis shpërndan.*

B U K U R I A

*Sado të jetë e ashpërjeta
njeriu m'i bukur do të vijë,
njeriu, mes luftëravë të veta,
rilind m'i madh te çdo fëmijë.*

S H K Ė N D I J A T

*Shumë ëndërrova të doja një njeri,
kështu më mbeti koka kthyer nga dashuria,
ëndërr pas ëndrre blova dhembje e vetmi,
në zemër mblodha gjithë muzgjet me
shkëndija,
duhej të prisja që vec ty të të desha,
i rrethuar kështu përjetësisht me xixëllonja,
jam unë që të dua vërtet gjer në eshtra,
apo ti të më bësh të të harroj, je e pazonja?*

DAL NË UDHE

*Ngrihem t'u blej qumështin fëmijëve,
shpejtoj hapin gazeten të marr
dhe mes aq edhe kaq «si u gdhive»
dal në udhë dhe jam udhëtar.*

*Dhe mes aq e kaq njerëzve në botë
jam patjetër dhe unë diçka,
mund të bëj një detyrë të rëndomtë,
mund të bëj edhe punë të mëdha.*

*Veç mos ndodhtë të mendoj asnjeherë:
«Qenkar unë njeriu që s'gabon».
Që kur veten ta ndiej mbi të tjerë,
që këtu edhe rënia fillon.*

AVNI RUSTEMI

*Vini veshin mbi mermer
në po fle a s'fle Avniu,
thonë dheu frymë merr
dhe me gjoks t'atij njeriu.*

*Po ta ndieni që s'merr frymë,
është ai çast kur vetë e mban
mos ia lozë zemra synë
të marrë mirë në nishan.*

ISA BOLETINI

*Fushë-Kosova desh një mal
me Korabin tok të rrin
dhe mbi djep të saj u ndal,
rriti Isë Boletinin.*

*Dhe kur nxin e bubullin
mbi Danub e mbi Ballkan,
balli i burrit Boletin
brof e bubullimat mban.*

TI DO TË VISH

*Ti do të vish,
prapë do të vish,
nga udha nga je nisur,
po flokët më s'do të t'i shprish,
ashtu siç t'i kam shprishur.*

*Në gjoksin tim që digjet zjarr
do rrish pa bërë zë,
po unë prapë si fillestar
s'di mund të të puth më.*

*Do desha t'isha prapë me ty
si viteve që s'kthehen
që kur të rrimë sy ndër sy
të skuqem e të dehem.*

*Pra, bëmë n'ëndërr të të shoh
e hidhmë në mendim,
që kurrë fundin mos e njoh,
siç njoh fillimin tim.*

DJALI QË KISH «PUNË TË MËDHA»

*Na humbi djali, thosh ajo,
s'e gjen gjë djalin, thosh ai,
nga punët nuk e gjen gjë, jo,
po bëhet edhe më njeri.*

*E shpinë më shpinë fjalët ngasin
e s'i zë gjumi gjer së voni,
me një përzierje kolle flasin,
si nga dy skaje telefoni.*

*E djali erdhi vonë e fjeti,
prapë erdhi vonë e prapë ra
se si nëpunës komiteti
e lodhkan punët e mëdha.*

*E nesër duhet prapë në zyrë,
pasnesër ka prapë referat,
e prapë u gdhi me sy të fryrë
nga të lexuarit në shtrat.*

Fëmijën gjer në kopshtin pranë
nuk bën ta mbajë ai në krah,
në krah çdo ditë mban filanë,
epror të punëve të mëdha.

As në pazar me trastë në dorë
s'bën të humbasë kohë ai
se rri me shokët kryesorë
e njihet gjer në ministri.

E një e ndal sa zbret nga shkallët
e tjetri pak më tej e pret
dhe ua dëgjon të gjithëve hallet
i mençuri në komitet.

Pa dal ta pyesim, thotë plaku,
të gjithëve hallet si ua zgjidh,
që mos na brejë as ne meraku
me verbëri porsi urith.

E pret e djali prapë vjen vonë
e gjuhëtrashur mezi flet
me një përzierje në firomë,
diçka si ponç a si fernet.

E nëna ndien sëmbim në brinjë,
në prehër kryet ia mbështet

*e dhembshurisht i shkul një thinjë,
«të mençurit» në komitet.*

*E dhembshurisht mbi faqe i bie,
e dhembshurisht për veshi e kap,
kur me sinqeritet fëmije
ai mbyll sytë e zemrën hap.*

*Ja, po ta them, moj nënë, copë,
ja, po ta them ty një sekret:
me «mirë, mirë e gur në torbë»
unë e kaloj dhe njëqind vjet.*

*Me mirë, mirë e përcjell njërin
e tjetrin «mos u bëj merak»
dhe as e ul, as e ngrë zërin,
e shkas si guri rrumbullak.*

*Pastaj i thotë si mënjanë,
si seriozisht, si me shaka:
Le ta kem mirë me filanë,
pa punë e madhe me ata...*

*E nënë e bir bisedën ndalin
e plaku që dëgjoi bërtet:
Tani, moj grua, e humbëm djalin,
të «mençurin» në komitet.*

*Dhe le t'i kem unë fjalët gozhdë,
po ky s'njeh as minierë, as fshat
e prit gjëmimet që nga poshtë
e prit shkarkimet që nga lart.*

LIRIKE PËR DHEMBJEN

Ku janë veglat e tua të rrojës,
ku janë rrobat e tua,
ku janë letrat me njollat e bojës,
që shkrove nxitimthi për mua?

Cila ka qenë ajo vajzë fshatare
që ti e ke dashur së pari,
cila ka qenë ajo hënë tinzare
që doli përgjoi pas mullari.

Cili lastar ta ka shtatin e burrit,
leshrat ç'korije me fletë,
syri në cilat shkëndija të gurit
të shkrep kur shkarkohen rrufetë?

Cila bumbeskë ka buzët e tua,
cili burim ta piu gjakun,
eshtrën ç'thëllëzë ta ka sqep e thua,
ç'mëz ta ka vrap fluturakun?

*Cilat vërshime në stinën ku linde
shfrehin për ty hidhërimin,
cilat gjëmime në muzg të një dite
sërish ta rikthejnë kuptimin?*

*Ishe i njomë e prapë hodhe mbi shpinë
luftën e jetës me derte,
ç'kishe të bukur e dhe për lirinë,
vdekjen e mbajte për vete...*

PLASA DHE PALESTINÄ

*Telekronikat ti i ndjek
e je poet, je udhëtar
e kur në tren fshatarin pjek,
«Ç'bën Plasa!» pyet si fshatar.*

*E Plasa grurë mbjell e rrit
e ty një varg i ri t'u ndez,
pastaj kujton një genocid,
pastaj një lajm palestines.*

*Po ç'lidhje ka që sjell ndër mend
pas Plasës Palestinën ti,
kallinjve të atdheut tënd
ç'ua vë këtë peizazh përbri?*

*O, po këtu një dhembje ka
se pas imazhit me kallinj
tymojnë gërmadhat e mëdha
atje, ku korren çiliminj!*

L O T I

*Ti digjesh,
ke temperaturë
e unë dhembjen s'ta shkul dot,
sado që veten e mbaj burrë
nëpër qerpik më shket një lot.*

*Në lotin që më ka shpëtuar
ka burrëri dhe foshnjëri
se them që globin mbaj në duar,
po ta shëroj tim bir nuk di.*

*Mbi biskun që nën breshët bie,
mbi degën që dot syth s'lëshon,
ngre këtë lot rubin fëmije
që sa dhe globi i madh peshon.*

*Mbi dëjetarin që vret mendjen
të gjejë ç'ka në filan yll,
ngre këtë lot me gjithë dhembjen
e çdo njomzaku që sy s'mbyll.*

*Ndër galaktika nesër bota
le të vozisë skaj më skaj
veç mos rëndoftë përmbi foshnja
zjarrmi e etheve të saj...*

Y J E T

Atdheu,
në caste të vështira,
I njeh më mirë
cilët ka bij,
si qelli, që kur bie errësira,
i zbulon yjet e tij...

BALADË PËR SHAHIN MATRAKUN

Gur mbi gur me gurë gjaku
shkolla e Vashave u ngrit,
po ç'kërkon Shahin Matraku,
ç'bën këtu dhe ky komit?

Rri ai në prag të shkollës,
rri mbështetur mbi dyfek,
nën opingë e ngrëna e shollës
si thëngjill për udhë e djeg.

E thërret të dalë prej dere,
ta braktisë atë sokak
Guri i Kamjes plot lîmere
që ka mbetur pa çak.

E pret Gora shpellë pas shpelle,
kush për mbrojtje, kush për hall,
po mbi palë fustanelle
shkrimin shqip ai po shpall.

E s'lëviz, jo, kurrë prej portës,
s'bën më prita mbi shkëmbinj
se bastis, dhespoti i Korçës
me sarafë e me myftinj.

E me helm e gjuhë zuzare
dhelpra e zezë mitropoli
vjen t'u djegë abetaret
vajzave që mbron ai.

Mbledhur te ky prag së largu
shkronjat shqip këndoijnë ato,
shkronjat që Shahin Matraku
nuk i njeh, po shumë i do...

BALADË PËR VASIL SHANTON

Ish larg prej shokëve e prapë s'ish vetëm,
ish plot me plagë e prapë s'ish vrarë,
po vdiste e prapë e zhveshi xhaketën,
kur sheh një bujk që hidhte farë.

E me të fundit fjalë e frymë,
na vishe ti, nxiton t'i thotë,
o supeveshuri me brymë
që dheun ngroh e vetë ke ftohtë.

Nën plumbat që nxitimthi e rrokën
t'ia gjenin zemrën që s'ia gjenin
e djathta këmbë i skuqte tokën,
e majta i ndizte buzëliqenin.

E ndërsa bombën mban me dhëmbë
e ndërsa shkrep sen shkrep nxituar
ç'sekrete djeg përmbi pëllëmbë
e rend me flakë nëpër duar?

*Mbi ç'dy krahina e nën ç'dy shtete
ç'Drin rend e dot s'arrin ndër shokë,
ç'të patreguara sekrete
i fut në gji memeces tokë?*

*Kështu nën vetëtimë të natës,
si vazhdë Drini rend e mbetet,
Vasili, klith zëri i Rozafës,
Veliu, përgjigjen gjithë qytetet...*

P O E T I

Në vetë kombin që e rriti
nuk është ushtar i thjeshtë ai,
po gur i rëndë prej graniti
që ze një vend në themeli.

Mes hapësirash, prapë i etur,
një dallëndyshe ka në gji,
edhe kur bie përtë fjetur,
përtë syzgjuar vargu rri.

E kombin që më shumë ta dojë
për çdo komb tjetër bëhet fli
e di ç'të shembë e ç'të ndërtojë,
në popull merr e jep gjeni.

Ndaj kërcënimit të çdo lloji
që vjen drejt popullit të tij
në ballë i djeg një plagë heroi
pa mbërritur hasmi në kufi...

ATA TË DY

Nga plagët i pat kapur lodhja e rëndë,
të mbetur fill pas luftëtarëve në pyll,
ajo një faqe e mbante mbi pëllëmbë
e tjetrën si të desh t'ia puthte ndonjë yll.

Ai padashur flokët ia kish prekur,
një dorë përmbi pushkë e mbante shtrirë,
sikur kështu me zemër dhe me hekur
atë të mund ta mbronte dhe më mirë.

Dhe i lidhën plagët fytyrë pér fytyrë
dhe èndërruan një èndërr që të dy,
ndërsa përbrenda pushkëve të tyre
i rrepti ligj i luftës s'mbyllte sy.

Se ndërsa zogjtë heshtnin nëpér fletë
e dhelpra e trembur stukej thellë në skutë,
zvarrisej kryqthyeri me helmetë
në mes èndrrën e bukur t'ua këputë.

ISTUASUM

Dhe ata u ngriten prapë më këmbë e shtinë
e mbërritën gjer tek ne e ikën tutje
duke shtrënguar plagët dhe lirinë
si dy të dashuruarit pas lufte...

M J E S H T R I

Gur përmbi gur daltoj me daltë
gjer shkëmbin bëj të flasë
dhe më pikon nga buzët mjaltë
mbi tel të tamburasë.

Jeta vërtet s'qenka lëndinë,
kollaj s'i qeshka nuri,
po unë djersij dhe bukurinë
ia nxjerr edhe nga guri.

I zhvoshk gishtérinjtë e mi të fortë
të veshur si me eshtër,
gjersa çdo gur me zë të ngrohtë
të më thërrasë «mjeshtër»

Dhe n'udhët gur pas guri shtruar
lëmuar me mundime,
ju ecni, njerëz, të gjuar
si mbi pëllëmbën time!

Q E R S H I T E

*Mbrëmja e kaltër zbret e ngrohtë,
nëna ngjitet për te djali
dhe në dorë mban një shportë
me qershi të hershme mali.*

*Shoqe shumë e shokë shumë
paska djali, thotë ajo,
po këtu si ta gjej unë
kush më shumë atë ma do?*

*Një dritare kapërcente,
kthente kokën tą vështronte
dhe një grusht qershi i jepte
çdo studenti që takonte.*

*Merri, bir, i thosh e dhembshur,
qofsh i çlodhur për provim,
do të jesh dhe ti patjetër
ndonjë shok i djalit tim.*

Kur të birin e pat parë,
kishte veç një grusht qershi,
se të gjitha i pat shpërndarë
midis shokëve të tij.

R O J A

Perbri çdo udhe, nën çdo lëmë,
në sup të çdo qyteti,
dhe unë pozicion kam zënë
me sy nga qielli e deti.

Nga qielli e deti e gjithë pikat
ku nxin shpesh horizonti
hetoj manovrat dhe taktikat
përtej një tjetër fronti.

Hetoj kur reja m'i fsheh yjet
një kërcënim rrufeje,
kalliri i grurit mbështet kryet
mbi sup betonarmeje.

Mund t'ish themel apartamenti
gjithë ky beton dhe hekur,
po do të ndodhte që qyteti
të gdhijej krejt i vdekur.

Kjo mund të ndodhë a s'mund të ndodhë
pa pasur fare mjegull,
siç mund të ndodhët a s'mund të ndodhët
një herë në një shekull.

Ndaj mbi çdo gjë të bukur jetës
më këmbë unë i rri roje,
jo thjesht si mbretëresha e bletës
që lind e vdes mbi zgjоje.

Vec për të drejtën dhe lirinë
dëshmor kam për të rënë,
së keqes gjoksin dhe për fqinë,
gjithmonë ia kam vënë.

MALI I VASHÈS

*C'emer tē la dashuria,
Mal i Vashës,
mal i mallit,
që ta ruash siç ruan shkëndijat
vetëm guri i sertë i strallit?*

Ç'vajzë tha: Në më do mua,
lidhmë me tärkuzë ylberi,
hidhmë supeve të tua,
ngjitmë atje ku rri skifteri!

Ç'vajzë mban mbi kurriz djali,
ç'plumb e ndoqi, ç'gojë i shpifi,
gjer e ngjiti majë mali,
hip e zbrit si gur Sizifi.

*Dhe e ngjiti dhe gajasi
dhe gajasi e oh nuk nxori,
edhe zemra e vajzës plasi,
mali në një varr i mori.*

WELI I AVSHES

Koha me ç'uror shkrep strallin
mes reales dhe legjendës,
shkrep e shkëndijoka mallin
e Romeos dhe Zhuljetës...

KUR HYJ NË KRUE

Shoh portën që Donika e leu me mjaltë,
pa kaloi,
shoh muret porsi burra të kapur brez më
brez,
potkonj përmbi shkëmbinj e lule mbi
potkonj,
mbi kuaj qimebardhë kalorës vetullzez.

Te cila kodër ke ngritur ti, Murat,
çadrën me të bukurat kopile të trishtuara?
Shpresonin nga Kruja nën haremin tênd
ambulant
edhe të rrëmbyerat në viset e pushtuara.

Ndofta më të trishtuar prej kopileve nazike
ishin eunukët me gushën e dhjamur, plot
rrudha,
të pérulurit e tu me pamje qesharake —
tragjike,
që e dinin se po plakeshin, pa u bërë kurre
burra.

ВУЛАНГУН КАРД

Deshe që diellin ta shihje mes shigjetave t'errur, ditët të nxira me korba, kufoma, mandata, por netët u ulën mbi ty si lëkurë buajsh të therur, plot neps e flligështi, të prera nga vetëtima dhe shpata.

Dhe kishte hyrë prej kohësh në rreshtat e
të vrarëve,
të të vrarëve që peng lanë eshtrat këtu,
si mund të fitohej, Murat, midis zjarreve,
zjarreve të shqiptarëve dhe kënetave të
haremave të tu...

KUFIJTE E ZEMRES

Kufijtë e zemrës,
që e ndiej
si rreh,
urren
e përkëdhel,
unë i kam shtrirë më përtej
sesa ky truall ku po shkel.
Më shqetëson një genocid,
një avion që foshnja bombardon,
përndryshe nuk do t'isha prind,
as dhe poet që militon.

RIZA KODHELI

Mbi Barmash po hynin Hunë,
xha Rizaj tha: Djema, ç'prisni,
pa mbështillmëni me gunë
dhe si gur më rrokullisni!

Gurë e gunë rrokullisur,
kur po binin që përpjetë,
kush besoi se mënga e grisur
mbante brenda saj rrufetë?

Brenda gune s'ish rrufeja,
ish mbështjellëjeta e tërë:
njëqind vjet, dyqind beteja,
që po bënte e që kish bërë.

Plot një shekull ndali e rendi
rogomisur gur pas guri,
kur si krahët e një shpendi
u hap guna e brofi burri.

Kush tha n're vare, thash dyseler
i bürave iš vare,
kush tha u cirukè pø hendljen
qđ plumbi qđ tu mawij?

A U D I

E sktonaq chinia e rø mli chinia
si brema parme kryna.

Nga kjo brofje turravrapi
lëshoi befas breshéríté,
dora, që një shekull hapi
zjarr mbi tri perandoritë.

So herre filje, r'k'zant sarttud q'zq i't
dhø p'r iš q'zqet flitej
dhø ihelut se hero ka an!

Be dhø k'zqet q'zqet idem daib n'zim se
du de aktarne jene zidher,
e k'zqet q'zqet mihtura!

K U L L A

*Si gjithë kullat e katundit
në luftë burra nxori,
po ndodhi që vec kjo ndër kulla
nuk derdhi gjak dëshmori.*

*Kur mbërritën burrat gjallë te porta,
s'u mburrën gratë e s'thanë:
Pa shih, nuk paska plumb, moj motra,
t'i kapë burrat tanë!*

*Se nulla s'desh ta mburrnin gratë,
po këngën desh ta pyeste
e hëm krenohej, hëm i ngjante
se mizën kish mbi festë.*

*A s'e kam ndjekur këmba këmbës
armikun gjersa shuhej,
e luftës gjoksin, i thosh këngës
s'ia vura ashtu siç duhej?*

*Kush tha s'ia vure, thosh dýfeku
i burrave tē vrarë,
kush tha u struke pas hendeku
që plumbi s'tē ka marrë?!*

*E shtohej thinja e re mbi thinjë
si bryma përmbi brymë
e s'ndodhi kurrë që nulla fqinjë
t'ia shkelte kullës synë.*

*Askush tē tilla fjalë s'nxori,
e s'desh tē tillë mynxyrë,
po nulla që s'dha gjak dëshmori
në ç'histori pat hyrë?*

*Sa herë flitej pér tē rënët
dhe pér tē gjallët flitej
dhe thuhej se hero ka qenë
dhe burri që nuk vritej.*

*Dhe nulla ia përcillte kullës
sérish fjalën e zgjuar:
Ja, ne akoma jemi udhës
e lufta s'ka mbaruar!*

*Se dhe kjo emërlashta punë
heronjtë e saj kérkoka
dhe paska po aq shumë furtunë
sa lufta që gjémoka...*

TË ZAKONSHMIT

Tre të zakonshëm krejt ata atje nën galeri,
të tre më të zakonshmet gra, plot thjeshtësi.

Dhe galeria seç u shemb e dihet ç'mund të
kur rrëth e rrrotull ti ke shkëmb e terr që të
përqesh.

E terr e shkëmb me dhëmbë e thonj s'i
hanin dot të tre,
siç ndodh në librat me heronj që s'i besojmë
ne.

E njëri ishte kurajoz e tjetri trim trefish,
të tretit shpresa krejt iu sos, po s'klithte
si kulish.

Dhe rendnin njerëzit rrëth e rrëth e ç'ish
makineri

ЯУТАККАНІ СЫРЫМЫ

çdo fërgëllim e drithmë e mbytnin me qysqi.

E mbanin vesh e me sinjal një mors që lind
dërgonin ngutshëm gjer nën mal nga zemra
e çdo njeriu.

E dita shkoi e nata ra e tjetra erdh sërish
e dolën prapë të tre ata të thinjurit trefish.

Trefish të thinjur në tri ditë nga dheu u
dhe befas shkëmbi i zi u ndrit, shih dielli
se kush tha.

Dhe se kush është që dielli shkon e dielli vjen
e ne na duket se ndriçon m'i bukur sesa
ish...

NJË BURRË I SPËRKATUR

Kalonte rëndë rëndë e kthyer prej kullote
e s'e trondisnin fare ndodhitë e kësaj bote.

Dhe s'donte hiç t'ia dinte kë kishte pro, kë
kundra,
as nga asfalti i ashpër ku ecte përmbi
thundra.

Rënduar nga jeshili i ngrënë gjatë ditës,
nga ujë i postafit, nga krundet e koritës,
lëshoi të lëngshmen bajgë në ecje, mes
asfalti e një njeriu kostumin e bardhë ia spërkati.

Dhe shau njeriu i nxehur kur pa në
pantallona
ca cirka bajge ngjitur që shponin si perona.
Dhe shau e ngriti dorën një lloj si për lanetin

MARS H FUNDRE

titilatqal i polonoff.

që para tij kjo qenie s'kish mbyllur
«rubinetin».
Dhe gati ish ta niste me letër larg ankimin
që t'ia pengonin lopës fodulle qarkullimin.

Kur, ja, u dha e shoqja me një borset
Europe,
me katër shishe qumështi, si katër sisë lope.

Na merri, burrë, i tha dhe rend· shpejt tek
dyqani!
Dhe shkuan prapa lopës kostumi dhe fustani.

Harroi burri i spërkatur ankimin kundër
bajgës,
e thirri tav' e kosit, e joshi cip' e ajkës...

MARSH FUNEBER

Monolog i kapitalistit

Bëjmë jetë e art borgjezi,
art me dy filozofi,
dhelpëria po s'na ndezi,
lufta nis me ujkëri.

Ne përsipër, ata poshtë,
kjo është luftë, jo shaka,
për të ngulur dhe një gozhdë
punën tonë e bëjnë ata.

Thundra jonë është e fortë,
shkel nën këmbë e mbaj nën fre
dhe kur ngrihen në revoltë
dimë prapë t'i ulim ne.

Se mes radhëve të tyre
bushtra jonë pjell këlysh,
ne të japim çdo lloj ngjyre,
veç në stanin tonë të hysh.

Veç kur bëjnë demonstrata
tatëpjetën marrim ne,
nga gushtngritjet na zë data,
po dhe ata uria i ze.

Ha ha ha dhe hi hi hi
sa rruffjane qenkajeta,
ç'i dërgon më parë ura
kujt s'ka bukë e bajoneta.

Kur të na mbarojnë hambarët,
kur të na shterojnë butet,
le të vijnë proletarët,
të na futin ndër tabutet.

Kur të na ndryshken raketat,
kur të na skadojnë çequet,
ne do hamë dhjamin tonë
gjer të na hollohen zverqet.

*Dhjamin tonë gjer ta tretim
turmës më parë i vjen fundi
do të vijë të lutet vetë
ta strehojmë tek tabuti.*

*Toka po na shket nën këmbë,
freri i botës po na shket,
po ne dhe me shpirt ndër dhëmbë
s'heqim dorë nga ky planet.*

*Vetëm me një lloj mënyre
ylli ynë perëndon,
po shpërtheu vullkani i tyre
që i thonë revolucion....*

ÇAST BUZË DETIT

Dallgë

dhe dremitje

e murmurimë.

madhështi pa shpirt,

pa dashuri,

ne të dy buzë ujrave po rrimë

guaska jonë-deti,

ne-perlat e tij.

Dhe kështu i thamë gjithë fjalët,

heshtim me një heshtje që s'na shkon,

po dhe deti i madh,

që ka kaq valë,

nganjëherë u bëka monoton.

KA ARDHUR NJERIU

Ka ardhur njeriu i pushtetshëm në jetë,
njeriu që shkelmoi perëndinë,
njeriu që dhe mbrapsht mund ta kthejë një
raketë,
njeriu që s'lejon një tjetër Hiroshimë.

Dhe s'është i dehur dhe s'është euforik
dhe kurrë naiv s'do të jetë,
që s'mund të ketë rrrezik atomik,
që s'mund të ketë një Luftë të Tretë.

Dinte ta hiqte samarin e rëndë,
po samari i ish ngjitur për lëkurë,
ta zhvoshkte lëkurën ndiente dhembje,
ta shkulte dhembjen duhej të ish burrë.

Dhe i bëri vetes një pyetje të vogël fare:
cilat janë qytetet që s'i ke ngritur ti,
me rrashtat e tua qenkan daltuar katedrale,
me artin tënd u zbukuruan vila e bashki.

САЛАДА В АЛГАСТАКИТ

Dhe tha: Pa tē pushojnë pakëz duart e mia,
së nxjerri naftën, së bluari gurë,
çdo tē bëjë vallë vetë qyrk zotnia,
pa tren e pa avion e pa veturë?

Kush do ta marrë sëpatën tē presë lisat,
kush do ta kapë qysqinë, çekanin, zdrukun,
kush do t'i bëjë tryezat pér ministrat,
kush do ta shtrojë belluzin pér kollukun?

Kush do t'i bëjë luftërat pa ushtarët,
kush nxjerrka ar pa duar minatore,
kush e prodhon sapunin pér litarët,
kush i pastron oborret mbretërore.

È zëmë se pushtime më nuk doni,
e zëmë se s'ju hyn më në punë ari,
po zverkun a e ulni tē lëroni,
po hekur shkrini dot si proletari?

*E s'është një gojë, po miliona gojë
që prisni lugë e nuk shkuleni për të ikur,
po sikur luga ime t'ju mëkojë
me fjalët që ju vetë i keni shpikur?*

*«Pa, hani fjalë, fjalë, fjalë,
hani pallavra, idera, teorema,
se prej andej dhe prangat kanë dalë
që ju i vutë në ligje e në poema.*

*Pa heshtni, karro e kamionë e trena,
heshtni, kuzhina, avionë e kryqëzora,
dhe heshtni telefona e vula e pena,
hesht, ti çdo gjë që lëviz dora.»*

*Dhe thirri me gjithë zërin e vërtetë:
Ka ardhur njeriu i pushtetshëm në jetë!*

BALADA E ĀRKITEKTIT

*Shuaj e ndiz një llullë shqope,
shuaj e ndiz e thith duhan,
nis mendimin mes Evrope,
hidh vështrimin mbi Ballkan.*

*Kapërcen një prag rrënoje
që pat qenë akademi,
del pastaj prej Voskopoje
duke marrë një grusht hi.*

*Udhë pas udhe, han pas hani,
shkoi një muaj, tjetri nis,
hapin hedh pas një karvani,
jo për Romë e për Paris.*

*Në shamizën ku mban hirin
tok me eshkë, uror e strall
ka adresën për të birin
që e do me brengë e mall.*

Ka adresën e Gjergj Sinës,
emërmadhit n'Austri,
emërmadhit mes Athinës
për stadium dhe akademi.

Dhe mbi urë të Budapestit
shkoi ky plak, po askush s'i tha:
Shih yt bir, Gjergj arkitekti
shkruar emrin ku e ka!

Dhe kur para Vjenës ndali
dhe kur përmes Vjenës shkoi
prap askush s'i tha: Shih djali
ç'udhë t'arta projektoi.

Në ç'pallate e sheshe e kthina,
në ç'kompleks perandorak
s'pat vënë vulë ai Gjergj Sina
i voskopojanit plak?

Plaku ku s'trokiti e s'thirri
gjersa mbrriti tek një prag,
ku i thanë se është i biri
në senat perandorak.

Mëdis njerzve më me sqimë,
më me emër, më me rang,

del i famëshmi Gjergj Sinë,
e papritur, seç u shtang
Kokën përmbi gjoks të plakut
e mbështet dhe qan dhe hesht,
midis njerëzve më të rangut
dikush tallet, dikush qesh.

Pa nxjerr tjetër fjalë nga goja
Gjergji u thirri me rënkim:
Një grusht hi nga Voskopoja
më dërgon atdheu im!

Ju këtë hi ma keni fyer
pa menduar ç'art ju dha,
gjithçka që e kam të vyer
ma dha ky që kam përkrah.

Këtë plak me këtë veshje
ju ma qeshni, unë e kam at'
dhe kjo s'është thjesht përqeshje
që ma bën një psikopat.

Nga ky hi i lashtë fisi,
sa e lashta Iliri
unë rilind si zog feniksi,
ju sérish më doni hi.

Se nga hiri e ke më lehtë
ti, zotni që më përqesh,
mjeshtrat që s'i lind dot vetë
nëpër popuj t'i rrëmbesh.

Portën ua përplasi inatçë
dhe të nesërmen s'kish frak,
po ish veshur krejt shqiptarçë
me opinga e me shajak.

Krejt shqiptarçë shkoi shëtitje,
krejt shqiptarçë në senat,
nën mëri e mërmëritje
të senatit «mecenat».

Si nën dritë të vetëtimës
njerëzit shihnin me habi,
që në artin e Gjergj Sinës
kish diçka nga veshja e tij.

Shihnin harqet e një ure,
shihnin veshjen me gajtan,
në ç'motiv arkitekture
ishte vënë ky xhamadan.

Në ç'portikë e ballë kështjelle,
në ç'teatër famëmadh

*rri kjo hapje fustanelle
ngrirë mbi mermer që zbardh?*

*U mbështet pas plakut djali
pastaj përmes Vjenës shkoi
dhe në ghendie katedrali
Shqipërinë rikujoj.*

*Si nën dritë të vetëtimës
njerëzit shihnin me habi
që në artin e Gjergj Sinës
kish diçka nga veshja e tij.*

DY ATENTATORËT

*Njëri matanë detit,
tjetri më këtë anë,
sy të ç'monumenti
dy djelmoshat janë?*

*C'thotë atentatori
me atentatorin?
Njëri qëllon mbretin,
tjetri perandorin.*

*Njëri Ferdinandin,
tjetri Emanuelin,
nëpër dritë naganti
dy mes shekujsh shkelin.*

*Njëri me De Radën,
tjetri me Naimin,
nga ç'furtunë e patën
shkrepje-zemërimin?*

Në paradë, kur mbretin
gjithë e përshëndetën,
rend Axhezilao
i ngul bajonetën.

Dihet nga Vasili
ç'merr Emanueli,
ç'plumb pas trëndafili
shkoi e «përkedheli».

Dhe fluturoi zërin
si zog të pastrukur:
Sillmëni krehërin
që të vdes i bukur!

Arbërisht i pari, idha
shqiptarishët i dyti,
asnje lak litari
zërin dot s'uambyti.

-
1. Arbëreshi Axhezilao i bëri atentat mbretit Ferdinand i dytë (1850)

EVSTRAT VITHKUQARIT

Ç'dashka Porta e Lartë vallë,
ç'klithka Patrikana,
ku i nis kaq mijë tellallë,
nën kaq mijë këmbana?

Emrin shqip që shpall shqiptari
e nëm hëna e kryqi
dhe mbi zverk i zbret hanxhari
pa të shkruar gjyqi.

Por pa shihni, kush pa pritur
dalika mes pazari
dhe mbi gjoksin e shkopsitur
mban nj'emblemë ari?

N'atë emblemë paska gdhendur
një zgrip jatagani:
«Jam shqiptar» dhe sypatrëmbur
shkon përmes Ballkani.

Индика

Ra mbi zverk tē tij hanxhari,
ra mbi kalldrëm koka,
vjen rreth fjalve «Jam shqiptar»
si rreth diellit toka.

M E D I O K R I

Kritikë nga poshtë,
mbështillem lëmsh,
kritikë nga lart,
rrëshqas me art,

zgjerohem më
dhe ja,
pak nga pak
u bëra rrumbullak...

Të hip më lart
të zbres më poshtë
s'kam kokë e tru,
s'kam këmbë e gju

dhe «ah» të hip
më mirë rrumbullak
dhe «oh» të zbres,
në mes...

F I S H E K U

Na ishte një fermer sinjor
që erdhi nëpër natë,
pa kishte sjellë edhe traktor,
kish blerë edhe argatë.

Dhe s'kish mision vec të lëronte,
e mjeshtërisht të hidhët farë,
po dhe të italianizonte
pak e nga pak këta fshatarë.

S'dihet ç'kontratë pati lidhur
e në ç'kadastër pat firmosur
dhe s'pyeti se sa ish e hidhur
kjo gjë për bujqit e leckosur.

Fshatarët qetë e tyre i donin
të kishin gjoks traktori,
po te ky ardhës po shikonin
zinxhirë kolonizatori.

Prandaj u ulën këmbëkryq
përpara kafshës me motor
dhe heshtur se ç'i bënë gjyq
sinjorit kolonizator.

Pastaj nga gjyqi heshtjemadh
seç kapërcyen një hendek,
i dhanë sinjorit veç një zarf,
brenda në zarf kish një fishek!

Sinjori iku nëpër xunkth
me një fishek me plumb të kuq...
Kjo ndodhi, thonë, atje në Sukth,
ku po lërojnë prapë ata bujq.

**C'MUNDOHEMI QË GJITHÇKĀJE T'I
JAPIM NGJYRË**

*C' mundohemi që gjithçkaje t'i japim ngjyrë
e s'ndodh ta gjejmë ngjyrën e bukur në çdo
fytyrë.*

*Vështroni mirë në thellësi të çdo njeriu
si zemërbardhi lufton mos ngrihet dot
zemërziu.*

*Jemi të qeshur ndaj një buzëqeshjeje që
shpërndan vlerë,
vlerën e tjetrit e çmojmë kur matjen e
bëjnë të tjerë.*

*Sa herë ke ndënjur me gjithë ata më poshtë
ke qënë asgjëja, i padobishëm për çdo lloj
se unë punë.*

*Sa herë kam ndenjur me «të mëdhenj», siç
i quan ti,
për ty padashur dhe unë kam marrë më
rëndësi.*

*Dhe nga mosgjëja, paaftësia, parëndësia
fillojnë e duken si pa kuptuar vlerat e mia.*

*Po qe se rrimë për njëri-tjetrin të vemë
nota
dhe të harrojmë se si zienjeta, se si rend
bota,*

*Sa dritëshkurtër, sa mediokër, sa qesharakë
bëhem i ne edhe për pleqtë dhe për çunakët.*

BESOJ NJERIUN

*Njeriun e mirë,
mes marrëzisë
në këtë shekull çoroditës,
unë s'e kërkoj si Diogjeni i lashtësisë,
që dilte me fener në mes të ditës.*

*E s'më pushton kjo ndenjë naivja,
Ç'u bë njeriu? — s'bërtas e s'lus,
e s'kërkoj strehë te primitivja
as tek Olimpi me Zeus.*

*Dhe nëse ka në botë hajdutër
e lufta e yjeve në vazhdon,
nuk shaj robotër dhe kompjutër,
s'mallkoj atom dhe elektron.*

*Njeriu i mirë është i pranishëm
dhe tek zbulimi më i vonshëm,
siç është tek buka e uji i pijshëm
dhe tek talenti i jashtëzakonshëm.*

*Dhe me çdo shpikje e shkrepje fjale
më njerëzor bëhet ai
dhe kur shtrydh dritën prej një vale,
dhe kur në muzg bën dashuri.*

*Sa për shëmtitë që s'rrëfehen,
kjo s'i takon emrit Njeri,
po veç dykëmbshave që ushqehen
me gjakun dhe gjeninë e tij.*

K A N D I L È T

*Kur një fshat ish mbledhur e po priste
që të ndizej llamba elektrike
se kush tha që çdo kandil të vdiste
edhe me një vdekje simbolike.*

*Dhe mbi ledh i vuri dhjetë kandilë,
mbledhur një nga një në dhjetë oxhakët
që të dhjetët ishin me fitilë,
që të dhjetët ishin dritëpake.*

*Dhe kur varg i pa, si dhjetë shenja,
t'u qëllonte dritën plakëruqe,
mos, bre bir, se s'janë ata mëllënja,
thirrën dhjetë burra me çibuqe!*

*Dhe ia mbajtën dorën me kobure,
dhe rrëfyen siç rrëfejnë etrit:
Ne me ta në oda dhe ahure
kemi parë sytë e njëri-tjetrit.*

Kur kandilin shpikën gjyshrit tanë
ky na ish moderni m'i lavdishëm,
po të dehur pishës «plac» s'i thanë
e s'nxituan që ta vrisnin pishën.

Dhe çdokush me një kandil në duar
drejt një llambe shkoi e lart e ngriti
na ke ndritur, tha, qofsh i bekuar,
tani bija jote le të ndriti!

L U M I

*Shpesh rri në breg të këtij lumi,
e shoh sikur është njeri,
pastaj gjithë natën s'më merr gjumi
me kotpushtetësinë e tij.*

*Pa thënë asgjë të re në botë
të tjeterohet shkon në det,
si dhe njeriu krejt i rëndomtë
mes të rëndomtëve humbet.*

*Veç kur trazohet nga përrenjtë
e ngre kaskada e shtratit del
e marr për një djalosh të sertë,
e admiroj si një rebel.*

*E shtrohet prapë e rri menduar,
e zgjohet prapë e heshtjen shkund,
e ç'ka nën këmbë e merr në duar,
e ç'ka mbi zverk e shëmb në fund...*

I KËM LARG ME NJË IKJE STUHIE

*Ik  m larg me nj   ikje stuhie,
erdh  m drejt nj  ri-tjetrit m   zem  rd  lir  ,
si ndaj nj   pikture t  r   dritte e hije,
q   duhet t'i largoresh,
p  r ta kuptuar m   mir  .*

*Stuh i e ndarjes,
s'di se kush e tha,
shuan zjarret e vogla
dhe ndez më tepër zjarret e mëdha.*

GRUAJA E FUSHËS

*Kërrusur mbi dy fëmijë,
u mëkon fisnikët gjinj,
foshnjës jetë i jep të pijë,
tokës lule dhe kallinj.*

*E shtrin dorën e florinjtë
një mbi plis e një mbi djep,
që rrit foshnjat dhe kallinjtë
bukurinë e vet u jep.*

BALADA E DHEUT

C'është ky karvan i gjatë
me kaq mushka e kuaj?
Dheu ynë nëpër natë
shkon në dhe të huaj.

Shkon në dhe të huaj lidhur,
shkon si mërgimtarët,
si njeri na vështron hidhur
sa të merr të qarët.

Ata nguten e s'po presin
gjer të hapet udha
e na ngjan sikur na ecin
me potkonj mbi rrudha.

Po kur udha të mbarojë,
udha që po nisin,
ty, o dhe, dheu i pagojë,
si do të gölltisin?

Vjen «Ferralba», mbledh argatë,
ble kafsharë e kuaj,
dheu ynë nëpër natë
shkon në dhe të huaj.

Mirë ai nuk di të flasë,
shkon se nuk ka gojë,
po nga ne që mbushim thasë,
kush do ta ndalojë?

Kush del zot mos të të hanë
dhe, o dheu i mirë,
që me gjysh stërgjyshët tanë
je përzier e shkrirë.

Që të vjedhin duar duar
e larg të degdisin,
kushedi sa je i çmuar,
ndaj t'ua ndërrojmë plisin!

Do t'ua ndërrojmë, tha m'i vjetri,
thasëve të tyre
do t'u hedhim nga ky tjetri
me përzierje zgjyre.

As nga tjetri, tha m'i serti,
as nga tjetri, thirri,

*tjetri ndofta del m'i shtrenjti
edhe se floriri.*

*Prej çdo dheu që mund t'u hedhim,
t'ashpër a të butë,
prapëseprapë vetveten vjedhim
njësoj si hajdutë.*

*O, po ç'bokërrimë e ç'vrragë
s'qenka dhe i çmuar,
e, moj toka jonë me plagë,
gjak e ar peshuar!*

*Mushka ime mbart mbi shpinë
shkëmbin copa-copa,
mushk' e huaj në ç'uzinë,
shkon e na i kthen topa?*

*Shih dhe panjën paskan prerë
përtej këtij bregu,
thënkan se e kanë blerë
për kondak dyfeku.*

*Nga ky dhe gatuan tyta,
nga ky dru kondakun
dhe e shkrep me duart e ndyta,
ti, o vjedhës gjaku.*

*E shkrep ti, po pse ne s'dimë
si ta shkrepim vetë?*

*Duarkryq po qe s'e rrime,
na shofshin rrufetë!*

*S'të këmbej, moj tokë e ashpra,
n'asnje gjëmë e shqotë,
as me lira, as me aspra,
as me tërë një botë.*

*S'të këmbejmë, thirren e thanë,
dhe, o dheu i mirë,
që me gjysh stërgjyshët tanë
je përzier e shkrirë.*

*Dhe çdo kush nis të shkarkojë,
nis të zbrazë thasë,
edhe dheu që s'kishte gojë
befas nis të flasë:*

*Nis të flasë edhe dushmani,
kafshon dhe nga vreri
se këtë herë përcjell karvani
krisma maliheri...*

TROKU I ZI

«... s'e gjunjëzoi dot atë krahinë dhe hodhi mes burrave një kalë të bardhë me pajime të florinjta. T'i hipë ai që kërkon të bëhet i parë, u tha...»

Gojëdhëna

1.

*E sollën ata nëpër natën e gjatë,
e sollën atë gjer këtu,
na, merreni, thanë, ta keni dhuratë,
t'i hipë më trimi nga ju.*

*Na merreni kalin, na hipeni kalin,
përhapej një zë ogurzi
e ç'dorë e padukshme anonte vargmalin,
e ç'burra po shtynte drejt tij?*

*E s'desh dërgimtari asnje lloj shpërblimi
për kalin me kaq salltanet,
veç gozhdën që donte dikur Nastradini
të varte pak qyrkun e vet.*

Veç gozhdën tē varte atje një fre kali
e s'donte gjë tjetër pastaj,
tē varte atje një mantel gjenerali
me shenj' e nishane pashaj...

2.

Ata që mbi kudhra po bënин kalitje
e shfrynin gjyrykun në zjarr,
vështronin sërish se mos kish plasaritje
çdo plor e sëpatë e hanxhar.

Ata që në lëmë po ndanin vec drithin,
vec bykun, vec farën e re
kërkonin nën këmbë tē gjenin urithin
që udhë u kish hapur nën dhe.

I Urti një krah me purteka e rroku,
e lidhi shtrënguar nën gju,
pa hë, u tha djemve që prisnin së toku,
ta thyejë më trimi nga ju.

S'e theu dot i pari, i dyti, i treti,
as burri, as djali s'e theu,
e plaku vandakun mbi gju e mbështeti
e nyjën e lidhur ia preu.

*Me duart e dobta që dridheshin lehtë
purtekat i theu një nga një,
pastaj me një dritë triumfi pa djemtë
dhe heshti kështu përgjithnjë.*

*E kali vërtitej krahinë më krahinë
të shbënte ç'u bë e ç'u thur,
gjer shqipja me shqipen u bë shpinë më
shpinë
e mbeti kështu në flamur.*

3.

Lëre atë kalë të vjetër atje
në gojëdhënën e vet rrëfimtar
dhe dëgjo një rrëfenjë të re
për një kalë të ri kryqëtar...

4.

Na merreni kalin,

*na hipeni kalin,
a s'thosh aleatja Angli,
e kush s'e mban mend atë Dejvis gjeneralin
që mbante kapistrën e tij?*

*Dhe vinin rreth tij Abas Kupët dhe Balli
e gjithë ç'pat joshur ai
e njeri i ndukte një fill kapistalli
e tjetri një torbë tagji.*

Nuk shfaqej ky kalë në shesh,

*mes Tiranës,
po malit, pas Shtabit u gdhi,
Atdheu nxirrte djemtë me thuprën e thanës,
te thana t'i vinte kufi.*

5.

*Dhe bëj hipodrom një bodrum ambasade
një Fulc*

*e stërvit djemtë e vet,
t'i kish kryqëtarë dekadë pas dekade
për tre e treqind e ca vjet.*

6.

Nuk jam kali biblik që nga hundët nxjerr
zjarr,
as i drunjti trojan, po jam kalë kryqëtar,
për potkonj mbath e marr katër kafka
pa varr,
një Hitler, një Khenghis, një sulttan, një
Qezar.
Kur më bien ata mbath tē tjerë e trokoj,
mbath potkonj tank e top e mbi glob shkel
e shkoj.

7.

Një bushtér nga sytë e barinjve u zhduk,
tregonte një herë një bari,
shkoi fshehur një pyll e ish mbarsur
me ujk
e zbriti në fshat përsëri.

E ndjekur prej qenve, që ndillte ajo,
dëfreu sa dëfreu dhe pastaj
me ujkun, që dihej në ç'dimër u njoh,
po priste këlyshët e saj.

8.

E niste dërgatën e re dërgimtari
dhe priste mesazhin e ri,
t'i thoshin se cili pat hipur i pari,
e cili pat zbritur prej tij.

E cili pat hipur e cili pat zbritur,
e cili pat rënë në hon,
e cili me thikë pas shpine goditur
s'pat vënë dot thonjtë mbi fron.

Kush mbeti me këmbën në çark t'yzengjisë,
kush mbeti me duart në fre,
nën thonjtë e potkonjtë e vargonjtë e
me trutë pérhapur përdhe

Priste gjakderdhjen, pastaj t'i fërkonte
pëllëmbët e vet si Heron,
pastaj mbas gjakderdhjes kuislingun që
ta hipte mbi kalë e mbi fron.

Dhe s'desh dërgimtari asnje lloj shpërblimi
pér kalin me kaq salltanet,
vec gozhdën që donte dikur Nastradini
të varte pak qyrkun e vet.

9.

Veç gozhdën Hrushovi kërkoi në Butrint,
veç gozhdën mes Ujit të Ftohtë e Sazanit,
ku të varte nëndetëset,

pastaj kalin xhind

ta trokonte

mbi popuj

nga ky kënd

i Ballkanit.

10.

O ti kalë kryqëtar,
hingëlli, hingëlli,
po për freri s'të marr
se unë huqin ta di.

*Hingëlli, hingëlli,
po s'kalon dot kötej,
trokun tënd unë tanı
di se si ta përkthej.*

11.

Isha krejt qimezi edhe qimja m'u zbardh,
isha krejt qimebardhë edhe qimja m'u nxi,
nën të vegjlit potkonj kam përbindëshin e
madh,
kam komplot e pushtim e pushtet e lakmi.

*Mos më pyesni për moshë e për sojin nga rrjedh,
pyesni kush më shaloi e as varr s'ka tani,
o, të mund t'i ringjall e sërish t'i rimbledh,
ç'Ballaban ta bëj fre e ç'Hamza yzengji?*

*E më duhet të rend e më duhet të brof
me një kokë në torbë e kufomën në thes,
që nga varri Çurçill gjer te varri Hrushov
që t'i pyes kë të le, kë të hip, kë të zgres.*

*Dhe nga shefi në shef e nga varri në varr
herë mbi katër potkonj, herë mbi tank e avion,
ç'udhë të vjetër të lë, ç'udhë tjetër të marr,
linjën Mekë-Vatikan apo Trojë Uashington?*

12.

*O ti kalë kryqëtar,
hingëlli, hingëlli,
po për freri s'të marr
se unë kurthin ta di.*

13.

*Ti nuk vjen as nga shtegu i dhive,
as nga udhë e nëndheshme e minierës,*

*vjen nga ahuret e izma — çengive,
hazdisur nga elbi i karrierës.*

14.

*Në trupin e ç'njeriu qenka ky han,
që ndezur një kandil mesjete mban?
E s'hyn e del atje çdo udhëtar,
po veç kalorësi e kali kryqëtar.*

*Hanxhesha Indiferencë portat hap,
rob Karrierizmi rend e frerin kap.
Xhol Servilizmi jelet përkëdhel
sejmen Liberalizmi elb i sjell.*

*Korb Kompromizmi i kruan thundrat —
thonj,
nallban Oportunizmi i mbath potkonj.
Pastaj xhind Egoizmi kalin — fron
hop, e shalon e larg trokon, trokon...*

*... Ah, ç'jele e ç'fre i florinjtë
një zë kukuvajke vjen rrëth,
e kujt i kërcasin gishterinjtë
si kyçet e zonjës Makbeth?*

*Pastaj ky vegim kaq tronditës,
s'i ndahet më kurrën e kurrës,*

*do katër potkonjtë e karriges,
do katër potkonjtë e veturës.*

*Në trurin e ç'njeriu qenka ky han,
që ndezur një kandil mesjete mban?*

15.

*Nuk jam kali biblik që nga hëndët nxjerr
as i drunjti trojan, po jam kalë kryqëtar.*

*Jo për kryq e për Krisht, as për hënë e allah
zemra popujsh po shkel, koka kombesh
po ha.*

*Një potkua Hitler, një potkua Truman,
me një bëj Hiroshimë, me një bëj Vietnam.*

*Një e mbaj Pinoçet, një e mbaj Vatikan
me një shkel mbi Mesdhe me një shkel mbi
Afgan.*

*Kur më bien ata mbath të tjerë e trokoj
me avion e raketë e me tank shkel e shkoj.*

*Yzengjité i kam shkallë, shkallë, — lak në
litar,
një fill fre president, një fill fre sekretar.*

*Njéri sy më bën tym, tjetri sy më bën zjarr,
Nuk jam kali biblik, po jam kalë kryqëtar,*

16.

*Mjaft më me përrallën «Na ishte luaní»,
mjaft më me «Na ish seç na ish,
na ishte Qezari, na ish Khenghis Khani,
na ish një Olimp perëndish»!*

*Pa shih ç'Golgotha, ç'trok i zi kryqëzate,
ç'fushatë mesjete e ka
një kalë si ky që gëlltit puse nafte
e koka arabi po ha?*

*S'ka xhungël të ketë kope kaq gjakësore
s'ka Mekë që mbledh kaq haxhinj,
sa gjithë dërgatat e sotme ajrore,
shaluan mbi kuaj — gjarpërinj.*

*Ç'i josh kryqëtarët e rinj me avionë
mbi tempujt e lashtë e të rinj,
as Mekë*

*e Keops,
e as Tebë*

e Dodonë,

po ari i lumenjve tē zinj.

*Na merreni kalin, na hipeni kalin
ç'tellall rend në shtetet — lakej
e ç'popuj i dalin pérpara ta ndalin
ta sprapsin, ta flakin pértej.*

*Në rërën e nxehdü potkonjtë ç'i ngelin
e shala ç'i mbetet pa shah,
atëherë potkonj ai mbath Izraelin
e shkel Palestinën me ta.*

17.

*Sa herë ata erdhën rrëth nesh nëpër natë
ta hidhnin atë gjer këtu,
na merreni, thanë, ta keni dhuratë,
t'i hipë më trimi nga ju.*

Dhe plaku pa burrin

dhe burri pa djalin,

*dhe djali pa foshnjën në djep
dhe shqipja e gdhendur në djep vështroi
malin
e mali rrufenë që shkrep.*

*Dhe s'vjen ai dot as nga shtegu i dhive,
as udhë e nëndheshme e minierës,
s'e gjen dot as hanin e izma — çengive,
as grazhdin e zi të karrierës.*

E sillet rreth nesh e i dalim përballë,
me fshikull çdo kush e përzhit,
I Urti i hedh një grusht miza ndër shalë
të brofë e të ikë si xhind.

E kush e pat këmbën në çark t'yzengjisë,
e kush i kish duart në fre
përplaset nën thonjtë e potkonjtë e lakmisë
e trutë i përhapen përdhe.

Kap thonjtë e potkonjtë e vargonjtë e
lakmisë
kush trokun e zi ndjek në terr
e kali mbërthyer çark t'yzengjisë
kufomën me vete ia merr.

18.

Dhe thënia e Të Urtit qenka gur i paçmuar
kur çmon kundërthënien e saj:
Me kalin e botës vërtet shkon kaluar,
po kthehesh përmbysur pastaj!